



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

2016

Bankat për Shoqërinë
Raport CSR



CONTENT

GOAL 1 - No Poverty 6
GOAL 2 - Zero Hunger 8
GOAL 3 - Good Health and Well-Being..... 10
GOAL 4 - Quality Education 14
GOAL 5 - Gender Equality 18
GOAL 7 - Affordable and Clean Energy 20
GOAL 8 - Decent Work and Economic Growth 21
GOAL 9 - Industry, Innovation and Infrastructure 23
GOAL 10 - Reduced Inequalities 26
GOAL 11 - Sustainable Cities and Communities 28
GOAL 12 - Responsible Consumption and Production 30
GOAL 13 - Climate Action 32
GOAL 15 - Life on Land 34
GOAL 16 - Peace, Justice and Strong Institutions 35
GOAL 17 - Partnership for the Goals 36
CULTURE, ART AND SPORT 38
SPECIAL AWARDS 41

Bankat flasin me një zë

Banks speak with one voice

www.aab.al

PARATHËNIE



I dashur lexues,

Për të tretin vit radhazi AAB publikon raportin vjetor të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave për industrinë bankare. Si një standard i ri i komunikimit me ju për atë që bankat kontribuojnë në shoqëri dhe ekonomi përveç veprimtarisë bazë, ky numër i tretë vazhdon të sjellë vlerë të shtuar në përpjekjet e AAB-së për të prezantuar kontributin e bankave në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të miratuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 2015. Industria bankare është sektori pararojë që ka vendosur të eci në këtë rrugë duke qenë shembull udhëheqës edhe për sektorët e tjerë të ekonomisë.

Ky numër, i përgatitur me mbështetjen dhe aistencën e Ernest & Young, sjell një strukturë të përmirësuar të prezantimit të kontributit të bankave në shërbim të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave. Këto Objektiva janë përmbledhur në tre seksione, si vijon:
Mundësitë për vlera të përbashkëta
Drejtimi përmes shembujve
Përgjegjësia Sociale e Korporatave

Mundësitë për vlera të përbashkëta janë ato mundësi që përbëjnë një vlerë të shtuar për bankat, si për aksionarët ashtu edhe për shoqërinë, ato përfaqësojnë veprimet krijimin e rrugëve më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse drejt rritjes ekonomike, prosperitetit dhe mirëqenies.

Në seksionin **Drejtimi përmes shembujve** mund të gjeni një përmbledhje të këtyre masave të ndërmarra nga çdo bankë e nivelit të dytë.

Në seksionin e **Përgjegjësisë Sociale të Korporatave** janë përmbledhur edhe veprimtari të tjera të tilla si donacionet dhe sponsorizimet, të cilat nuk konsiderohen si OZHQ.

Gjatë vitit 2016, bankat kanë shpenzuar përafërsisht 4,530,000 EUR për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit, mirëqenien e qytetarëve, ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e arsimit dhe kulturës. Këto veprimtari kanë vendosur lidhje më të ngushta mes bankave dhe shoqërisë, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj nevojave dhe domosdoshmërisë së përmirësimit të aspekteve të veçanta të jetës së komunitetit. Gatishmëria e bankave për të zgjidhur dhe plotësuar kërkesa të caktuara të jetës së komunitetit ka pasur një ndikim të madh në përmirësimin e imazhit të industrisë bankare, si më të përgjegjshme ndaj nevojave të zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë, përveç rolit që ato luajnë nëpërmjet veprimtarisë bazë.

Duhet t'i lexoni dhe t'i ballafaqoni ato që pasqyrohen në këtë raport me ato që vetë ju mund të keni qenë përfitues. Kjo do të na shërbejë edhe më mirë për të qenë më shumë nën vëzhgimin tuaj.

Urojmë që ky raport t'ju sjellë sa më pranë copë nga realiteti, dhe praninë e bankave në jetën tonë të përditshme! Lexim të këndshëm!

Periklis Drougkas
Kryetar

AAB MEMBERS

 ALPHA BANK	 abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	 CREDINS bank
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPTARE	 Fibank First Investment Bank	 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rëndësi kanë vlerat	 INTESA SANPAOLO BANK Albania
 NBG Bank	 ProCredit Bank	 Raiffeisen BANK	 SOCIETE GENERALE ALBANIA
 TIRANA BANK	 UNIONBANK	 UBA Banka e Bashkuar e Shqiptare United Bank of Albania	 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

Eliminimi i varfërisë së të gjitha formave në të gjithë botën

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit:

Mbi 14,000 EUR dhe kontribute bamirësie nga punonjësit e bankave.

OBJEKTIVI #1

Eliminimi i varfërisë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modelet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankingun për 2.5 miliard të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare dhe mikro-sigurimin për rritjen e mbrojtjes sociale.
- Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe personat e cenueshëm, që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe akses në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologjive të reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikrofinancën.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Më 20 maj, në Ditën e Fëmijëve Jetim, **Banka Kombëtare Tregtare** organizoi një fushatë ndërgjegjësimi mes punonjësve të saj të quajtur “Donacione nga të gjithë në Bankën Kombëtare Tregtare në ndihmë të jetimëve në komunitet”. Të gjithë artikujt e grumbulluar nga i gjithë personeli, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Tiranë, u dhuruan 62 familjeve, sipas nevojave të tyre specifike.

Më 1 qershor, për Festën e Fëmijëve, punonjësit e **Bankës Kombëtare Tregtare** dhe **Intesa Sanpalo Bank Albania**, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq në Shqipëri, grumbulluan pako me ushqime dhe veshje për fëmijët jetimë dhe persona të tjerë në vështirësi financiare.

Credins Bank ofroi mbështetjen e saj për “Domenick Scaglione”, një Fondacion Shqiptar për Fëmijët, i cili mbështet fëmijët në nevojë duke nxitur zhdukjen e varfërisë dhe duke kontribuar për një të ardhme më të sigurt

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

dhe një jetë të shëndetshme.

NBG Bank Albania ofroi mbështetje aktive për qendrën e kujdesit ditor për fëmijët e strehuar në Shtëpinë Ortodokse të Shpresës, e cila drejton dy jetimore për fëmijët e moshës 5-15 vjeç, të cilat ndodhen në qytetin e Durrësit dhe Gjirokastrës.

Raiffeisen Bank krijoi një bashkëpunim të frytshëm me organizatën “Fundjavë ndryshe” për të dhuruar çanta shkolle dhe mjete mësimore për 200 fëmijë të një shkolle që ndodhet në periferi të Tiranës.

Fundi i vitit ishte i mbushur plot aktivitete bamirësie në Raiffeisen Bank. U organizua një banket/panair dhe të gjitha paratë e grumbulluara u përdorën për blerjen e materialeve aq shumë të nevojshme për ndërtesën e Jetimores. Gjithashtu, po gjatë këtij aktiviteti, u mblodhën dhurata dhe u dërguan në institucionin “Zyber Hallulli”. Këto dhurata u dhuruan dhe u paketuan nga fëmijët e punonjësve të Raiffeisen Bank për fëmijët e strehuar në këtë institucion.

Tirana Bank

Në kuadër të projektit “Varfëria nuk ka moshë”, fokusi i të cilit u përqendrua në mënyrë specifike te disa fëmijë që jetojnë në kushte të vështira në Sinjë, Berat, Tirana Bank grumbulloi donacione të ndryshme, lodra, veshje dhe ushqime jo vetëm nga stafi i bankës, por edhe nga individë të interesuar për të kontribuar në këtë projekt.

Stafi i Bankës së Degës Gjirokastrër përgatiti pako me ushqime në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në nevojë që jetojnë në këtë qytet.

Më 22 dhjetor, 100 jetimë që jetojnë në komunitet morën dhurata nga Banka në përfundim të një koncerti të organizuar nga Tirana Bank dhe Kryqi i Kuq.

Punonjësit e **Union Bank** dhuruan dhurata për fëmijët në Tiranë dhe Elbasan.



Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i të ushqyerjes, dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit:

Mbi 32,000 EUR dhe kontribute bamirësie nga punonjësit e bankave.

OBJEKTIVI #2

Eliminimi i urisë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.
- Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh. financimi i farës dhe risive në mikroushqyerje).
- Sigurimi i aksesit për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cenueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Credins Bank, Banka e Parë e Investimeve Shqipëri, ProCredit Bank dhe Union Bank sponsorizuan kartolinat e fund vitit duke promovuar vizatimet e fëmijëve të Fshatit SOS në Shqipëri, si një instrument për mbështetjen e tyre.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania dhuroi 250 pako Krishtlindjesh në të gjitha qytetet ku operon banka, të cilat përmbanin pako me ushqimet bazë. Një aktivitet u zhvillua në një nga qendrat sociale në Tiranë, ku u shpërndanë 50 pako me praninë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Credins Bank

- “Credins Bank dhuron” ishte iniciativa e ndërmarrë nga punonjësit e 57 degëve të kësaj banke, si dhe punonjësit e zyrave qendrore, e cila u përqendrua në organizimin e dhurimit të veshjeve dhe lodrave për fëmijët në nevojë. Kjo iniciativë u shtri edhe në shumë institucione të tjera, si p.sh. “Qendra Kombëtare e Emergjencave” dhe institucione të tjera me natyrë komunitare.
- Një tjetër aktivitet bamirësie i kësaj banke ishte bashkimi me thirrjen e Radio Club FM në një program maratonë që u transmetua 48 orë drejtpërsëdrejti, si dhe me organizatën “Fundjavë ndryshe” në ndihmë të familjeve në nevojë.

Në fund të vitit, stafi i **Raiffeisen Bank** u bashkua me organizatën “Fundjavë ndryshe” dhe dhuroi ushqim për familjet që jetojnë në varfëri të skajshme. Kontributi i tyre arriti në një sasi rreth dy ton ushqim, të cilat iu shpërndanë 15 familjeve që jetojnë në varfëri të skajshme. Sasia e këtyre ushqimeve të shpërndara mbulon rreth 3 muaj konsum ushqimor për këto familje.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Në Ditën Botërore të Urisë, 28 maj, **Banka e Parë e Investimeve Shqipëri** siguroi mbështetjen e saj për Jetimoren e Shkodrës. Qëllimi i këtij sponsorizimi ishte rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit lokal të biznesit për të dhënë kontribute njësoj si Banka e Parë e Investimeve, në mbështetje të shoqërisë civile në Shqipëri.

Nismat e **Societe Generale Albania** përgjatë gjithë vitit:

- Me rastin e festës së Vitit të Ri, banka vendosi të ndërmarrë një nismë bamirëse në mbështetje të një familjeje që ndodhet në Grabian/Lushnje, e cila jeton në kushte të varfërisë së skajshme;
- Donacione dhe veprimtari zbatimje për fëmijët e shtruar për trajtimin e leukemisë;
- Argëtim dhe ditë speciale me të moshuarit e strehuar në azil (qyteti i Beratit);
- Dhomë rekreative për fëmijët me autizëm dhe sindromën Down;
- Donacione dhe zbatimje për fëmijët jetimë në Shkodër dhe Tiranë;
- Donacione dhe mbështetje për foshnjat e braktisura në maternitet (Djepi i engjëjve);
- Donacione për familjet që jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme;

Më 25 dhjetor, **Tirana Bank** sponsorizoi aktivitetin “Gatuaj një pjatë më shumë”. Të ftuarit e nderit në këtë tryezë ishin persona të pastrehë, të varfër dhe të vetmuar.

Union Bank

- Banka vijoi me projektin e Shërbimit të Dedikuar në jetimoren “Zyber Hallulli”.
- Gjithashtu, Union Bank sponsorizoi pjesëmarrjen e fëmijëve të jetimores “Zyber Hallulli” në kampin veror të sportit “Juventus Camp Tirana”.




OBJEKTIVI #3

Sigurimi i një jete të shëndetshme

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.
- Shqyrtimi i hartimi të politikave që përfshijnë shërbime të parasë së lëvizshme për transferimin efikas të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me aksesin në kujdesin shëndetësor shtetëror.
- Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.
- Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania

- Banka financoi pajisjet për spitalin e pediatriisë të Beratit.
- Salla e kirurgjisë së Spitalit të Librazhdit u rinovua duke vendosur një ndriçues të re në tavan, i cili është një element thelbësor për ndërhyrjet kirurgjikale. Gjithashtu u dhurua edhe një pajisje monitorimi, së bashku me një aspirator për pacientët, të cilat përdoren gjatë ndërhyrjeve.
- Po ashtu, Banka ofroi mbështetje edhe për Spitalin e Përmetit, duke blerë dhe duke i dhuruar këtij spitali

LEADING BY EXAMPLE

një elektrokardiograf, një teknologji jo-invasive që mat përcjellshmërinë totale elektrike të toraksit, së bashku me shërbimet përkatëse të mirëmbajtjes për përpunimin e vazhdueshëm të parametrave të ndryshëm kardio dinamikë.

- Banka financoi rikonstruktimin e sallës së operacionit të Spitalit të Laçit, i cili u vjen në ndihmë 40 000 pacientëve të komunitetit lokal.

Banka Kombëtare Tregtare

- Banka sponsorizoi blerjen e pajisjeve mjekësore laboratorike për Qendrën e Shëndetit Publik “Xhafer Kongolli” në Elbasan. Kjo pajisje o të shërbejë për nxjerrjen e analizave me cilësi më të lartë dhe për automatizimin e rezultateve, çka do të thotë një diagnostikim më i shpejtë dhe më i mirë i sëmundjes së pacientit.
- Banka financoi botimin e 500 kopjeve të botimit përmbledhës së legjislacionit shëndetësor në emër të Institucionit të Shëndetit Publik.

Credins Bank ofroi mbështetje për disa spitale dhe qendra shëndetësore për të përmirësuar dhe rinovuar pajisjet e specializuara që përdoren në të gjithë vendin. Banka i ofroi mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë për blerjen e pajisjeve mjekësore, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe performancës së shërbimit në Qendrën Shëndetësore të Pustecit dhe në Qendrën Shëndetësore të Kelmendit, Spitali Rajonal “Omer Nishani” në Gjirokastrë.

Çdo vit, përmes konkurseve të ndryshme të organizuara nga kanalet e mediave sociale të **Bankës së Parë të Investimeve Shqipëri**, banka ndërmer fushata gjithëpërfshirëse duke dhënë çmime të konsiderueshme për grup-mosha të ndryshme. Nëpërmjet këtyre çmimeve, Banka e Parë e Investimeve në Shqipëri synon të kontribuojë në mirëqenien e shoqërisë së përfshirë.

American Bank of Investments dhe **Intesa Sanpaolo Bank Albania** iu bashkuan aktivitetit “Run for Children 2016”. Fondet e grumbulluara nga ky aktivitet do të përdoren për trajtimin mjekësor të fëmijëve në luftë me kancerin.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Iu bashkua fushatës për Sensibilizimin mbi Kancerin e Gjirit të iniciuar nga YWCA Albania, duke u përcjellë informacion të gjithë kolegëve për rritjen e ndërgjegjësimit për kontrollet periodike për të shpëtuar jetë!
- Më 31 maj, në Ditën Botërore të Dhanit, punonjësit e degëve të Gjirokastrës, Lushnjës dhe Degës H.Tahsim shmangën pirjen e duhanit gjatë tërë ditës me synim rritjen e ndërgjegjësimit për dëmet e shkaktuara nga pirja e duhanit ndaj shëndetit të gjithsekujt.



NBG Bank Albania dhuroi pajisje zyre për spitalet publike të Gjirokastrës dhe Pogradecit në mbështetje të veprimtarisë së tyre të përditshëm të punës në shërbim të komunitetit.

Raiffeisen Bank u bashkua me nismën e Ministrisë së Mbrojtjes duke sponsorizuar rehabilitimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve të Ushtarakëve të prekur nga Çrregullimet e Spektrit të Autizmit. Gjithashtu, banka mbështeti Fondacionin e Nënës dhe Fëmijës për organizimin e një Mbrëmje Gala për grumbullimin e fondeve për mbështetjen dhe promovimin e shëndetit të fëmijëve. Po ashtu, janë ndërmarrë edhe dy projekte të tjera të rëndësishme në sektorin e shëndetësisë për Spitalin e Fierit dhe të Lezhës.

Stafi i **Union Bank** mbështeti fushatën sensibilizuese #UnëMbrojFëmijët#. Në të gjitha degët e bankës, klientëve u është përcjellë rëndësia e denoncimit dhe reagimit ndaj çdo lloj forme kërcënimi ose keqtrajtimi ndaj fëmijëve, duke përdorur Aplikacionin e Raportimit ose numrat e telefonit 116, 111, 129.

Në prill, **Raiffeisen Bank**, **Banka Ndërkombëtare Tregtare** dhe **Union Bank** zhvilluan një fushatë sensibilizuese për publikun për Ditën Kombëtare të Autizmit.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

American bank of Investments dhe **Credins Bank** sponsorizuan rehabilitimin e ambienteve përreth të Spitalit Rajonal të Durrësit.

Credins Bank

- Iu bashkua nismës së Presidentit të Republikës dhe mbështeti aktivitetin e organizuar për rritjen e ndërgjegjësimit për fëmijët dhe individët me sindromën Down.
- Dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e mjedisit të punës dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit për Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Shëndetit. Kjo nismë bëri të mundur sigurimin e pajisjeve për mobilimin e infrastrukturës së brendshme të Spitalit Rajonal Vlorë, Zyrës së Ekzekutimit Tiranë dhe Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, me synim përmirësimin e ambienteve dhe një cilësi më të lartë të shërbimeve të ofruara.
- Ofroi sponsorizim për Bashkinë e Lezhës, duke organizuar një aktivitet festiv me rastin e “Ditës së Pelegrinëve”, çka promovon një jetë të shëndetshme dhe mirëqenie. Banka sponsorizoi “Shtëpinë e të Moshuarve” përmes rehabilitimit të ambienteve të brendshme.

ProCredit Bank dhe **Tirana Bank**, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, ofruan mbështetjen e tyre për rinovimin e kopshteve, si pjesë e projektit “Adopto një kopsht”.

Tirana Bank

- Më 1 qershor, Tirana Bank në bashkëpunim me Down Syndrome Albania, mbështetën organizimin e festës së fëmijëve, si dhe 2 vjetorin e Qendrës së Arritjeve dhe Zhvillimit të Fondacionit “Down Syndrome Albania”. Tirana Bank përkrahu Bashkinë e Korçës për festën e 1 qershorit dhe Bashkinë e Dropullit për projektin e rindërtimit të rrugëve në zonat rurale të bashkisë.
- Ofroi mbështetje financiare për rindërtimin e ambienteve të jashtme të Qendrës Shëndetësore Vorë.

DHURIMI I GJAKUT

Dhurimi i gjakut ka qenë gjithmonë një nga fushat kryesore ku bankat kanë qenë shumë aktive. Punonjësit e saj kanë treguar anën e tyre njerëzore me një pjesëmarrje shumë të gjerë. Bankat bashkëpunuan për organizimin e fushatave sensibilizuese në emër të organizatave të ndryshme si: Organizata Shqiptare e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut, në kuadër të nxitjes dhe shpërndarjes të dhurimit vullnetar të gjakut në Shqipëri.

- Alpha Bank Albania
- Credins Bank
- Banka Ndërkombëtare Tregtare
- Intesa Sanpaolo Bank në Shqipëri
- NBG Bank në Shqipëri
- Raiffaisen Bank
- Societe Generale në Shqipëri
- Tirana Bank
- Union Bank



OBJEKTIVI #4

Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunim me institucionet financiare dhe qeveritë për të rritur dhe/ose investuar në financimin novator për projektet e arsimit.
- Zgjerimi i aksesit dhe shfrytëzimi i kursimeve personale dhe produkteve të kredisë për t'u ardhur në ndihmë familjeve për të planifikuar dhe financuar shpenzimet e arsimit.
- Ofrimi i këshillimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e margjinalizuar për përmirësimin e rezultateve në mësim dhe aksesin në industrinë e rrjetit e talenteve të larmishme, çka ofron modele thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale.
- Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi të caktuara, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare

- Banka është një nga partnerët kyç të FASTIP në UAMD dhe gjatë këtyre 9 viteve të fundit ka kontribuar në mënyrë masive në këtë program unik të Partneritetit Publiko Privat, midis Qeverisë Shqiptare dhe Gjermane, UAMD-it dhe Partnerëve të Biznesit në Shqipëri. Deri më sot, Banka Kombëtare Tregtare ka punësuar 97 të diplomuar të FASTIP (9% të punonjësve aktual të Bankës Kombëtare Tregtare), ka sponsorizuar 154 studentë, 44 studentë që ndjekin aktualisht këtë vit akademik.
- Banka dhuroi për Shoqatën kulturore dhe vëllazërore "Istanbul" (IBCA) një ndërtesë 3 me katër kate me sipërfaqe

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

214.4 m² dhe një truall me sipërfaqe 4300 m², që ndodhet në fshatin Barhaj në Shkodër. Prona ndodhet 4.5 km larg nga qendra e qytetit dhe IBCA e shndërroi këtë ambient në konvikt për akomodimin e nxënësve. Shoqata kulturore dhe e vëllazërisë Istanbul u themelua në Shkodër në vitin 1999. Kjo Shoqatë, e cila synon nxitjen e miqësisë midis Turqisë dhe Shqipërisë, është e përfshirë në fushën e arsimit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Banka priti në ambientet e saj grupe të ndryshme studentësh nga universitete të ndryshme, me qëllim dhënien e shpjegimeve të hollësishme mbi rezultatet financiare dhe rëndësinë e treguesve financiarë, duke u bazuar në shembuj konkretë dhe sfidat kryesore të strukturës së auditimit të brendshëm dhe funksioneve të tij.
- Pas lidhjes së marrëveshjes me Ambasadën Gjermane, Intesa Sanpaolo Bank në Shqipëri do të veprojë si «garantor» ndaj Ambasadës Gjermane në Shqipëri për studentët që aplikojnë për vizë studentore, me qëllim lehtësimin e procesit të vizave për këtë kategori klientësh.

Kredi për studentë, të siguruara nga **Alpha Bank Albania**, **Intesa Sanpaolo Bank Albania**, **Raiffeisen Bank** dhe **Union Bank** me synim mbulimin e shpenzimeve të arsimit për përfundimin e studimeve të këtyre studentëve. Qëllimi kryesor i kësaj kredie ishte dhënia e mbështetjes financiare për studentët kurdo që ata të kishin nevojë për fonde, me komision 0%. Nga këndvështrimi i përgjegjësisë sociale, ky produkt përbën një mundësi për të kontribuar në gjithë përfshirjen financiare dhe fuqizimin e të rinjve.

ProCredit Bank vijoi të ofrojë Programin "ProCredit Entry", një program trajnimi gjithëpërfshirës për zhvillim i dedikuar për të diplomuarit rishtazi nga fusha të ndryshme. Banka inauguroi qendrën rajonale të trajnimit, e ndërtuar në Prevallë, Prizren, e cila do të ofrojë trajnime të avancuara dhe Programin "ProCredit Entry" për stafin e degëve të ProCredit Bank që operojnë në rajon, si Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Në kuadër të **Javës së Parasë**, Shoqata Shqiptare e Bankave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizuan aktivitete të ndryshme edukative dhe sensibilizuese për fëmijët dhe të rinjtë, si p.sh. seminare, leksione, konkurse në shkollë dhe në TV, vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë, vizita në bankat tregtare dhe në klasa për leksione të hapura. Këto veprimtari u mbështetën nga **Alpha Bank Albania**, **American Bank of Investments**, **Credins Bank**, **Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri**, **Banka e Parë e Investimeve Shqipëri**, **Raiffeisen Bank**, **Tirana Bank** dhe **Union Bank**.



Junior Achievement (JA) Shqipëri është një program i vendosur në zbatim në shkollat e mesme (të përgjithshme dhe profesionale) i sponsorizuar nga AADF. Gjatë vitit 2016, për të dytin vit radhazi, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** organizoi thirrjen për “**këshillimin vullnetar**”, drejtuar të gjithë kolegëve me aftësi të dalluara në ligjërime dhe me aftësi elokvente. Në kuadër të kësaj thirrje u ftuan të gjithë këshilluesit vullnetarë në shkollat e mesme shqiptare, duke vendosur në dispozicion aftësitë e tyre praktike të fituara në sektorë të ndryshëm të biznesit, me qëllim dhënien e leksioneve të ndryshme mbi sipërmarrjen për të rinjtë. shqiptar.

“**Drejtues për një ditë**” është një nismë e JA, e cila synon të kultivojë një brez të ri drejtuesish. 45 të diplomuar rishtazi të shkollave të mesme përjetuan një ditë të veçantë duke u bërë pjesë e një dite tipike pune me drejtues dhe persona të rëndësishëm të sektorit publik si dhe me personalitete të shquara të komunitetit të biznesit në Shqipëri. **Alpha Bank në Shqipëri, Intesa Sanpaolo Bank Albania Shqipëri, Tirana Bank**, së bashku me institucione të tjera të sektorin publik dhe privat morën pjesë në këtë iniciativë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Shqipëri

- Bënë të mundur blerjen e 100 librave “Arti i komunikimit”. Të ardhurat e grumbulluara nga shitja e këtyre librave u dhuruan në ndihmë të fëmijëve në nevojë dhe familjeve të tyre.
- Banka ishte një nga sponsorët ekskluzivë të konkursit “Sipërmarrësit e së nesërme”, i cili u zhvillua në muajin maj në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, i organizuar nga Junior Achievement Albania në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me **American Bank of Investments** dhe partnerë të tjerë, organizuan më 1 qershor “Ditën e të Drejtave», duke e konsideruar si përmbushjen e objektivit të Planit Kombëtar #UnëMbrojFëmijët#.

Punonjësit e **Alpha Bank Albania** dhe **American Bank of Investments** u bënë pjesë e projektit «Rruga drejt suksesit», i cili synonte nxitjen e kapaciteteve ndërpersonale të punonjësve. Të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga ky aktivitet u dhuruan për bamirësi.

Banka Kombëtare Tregtare

- Mundësoi sponsorizimin e aktivitetit të organizuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Vlorës me rastin e përfundimit të vitit akademik 2015-2016. Ky aktivitet kishte për qëllim zbavitjen dhe edukimin e fëmijëve përmes veprimtarive artistike dhe sportive.
- Mundësoi sponsorizimin e një aktiviteti sportiv dhe artistik të organizuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës me rastin e përfundimit të vitit akademik 2015-2016. Ky aktivitet është një traditë e përvitshme me ne qendër zbavitjen e fëmijëve nëpërmjet veprimtarive të ndryshme.
- Banka sponsorizoi çmimet për tre fituesit e konkursit të pikturës të organizuar nga Qendra Residenciale Universitare. Për të rritur numrin e pjesëmarrësve, vizibilitetin dhe mundësinë e përthithjes së këtij konkursi, çmimi i dhuruar për tre vendet e para ishte përjashtimi i pjesshëm ose i plotë nga tarifat vjetore të akomodimit.
- Banka dhuroi mobilimin e dhomave për studentët e Institutit të Studentëve të Verbër.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

- Banka sponsorizoi instalimin e pajisjeve të mbikëqyrjes me video në disa shkolla në Durrës. Kjo ishte vetëm faza e parë e projektit të iniciuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Durrësit për instalimin e pajisjeve të mbikëqyrjes me video në shkollat e Durrësit, duke rritur kështu nivelin e sigurisë në këto shkolla rajonale.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në 21 Shkurt (Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare), punonjësit e Degës së Vlorës, së bashku me disa klientë, mbledhën pothuajse 30 libra për fëmijët e Jetimore shtetërore në Vlorë duke përdorur sloganin: “Dhuro një libër - dhuro njohuri - dhuro dashuri!”.
- Më 8 shtator, në Ditën Ndërkombëtare të Analfabetizmit, kolegët e Degës Blvd. Zogu I, në bashkëpunim me Shoqatën “Shkej”, dhuruan libra për fëmijët romë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe **Veneto Banka** ofruan mbështetjen e tyre ndaj Universitetit Katolik NSBC për organizimin e Ceremonisë vjetore, e cila konsiderohet si një mundësi e shkëlqyer për krijimin e rrjeteve të kontaktit mes studentëve, palëve të interesuara dhe partnerëve strategjikë.

NBG Bank Albania sponsorizoi botimin e librit “Rrugëtim me Historinë”, shkruar nga Prof. Dr. Paskal Haxhi, një nga kontribuuesit e parë të NBG Bank në Shqipëri.

Raiffeisen Bank

- Ofroi mbështetjen e saj për Drejtorinë Arsimore të Vlorës dhe Shkodrës në aktivitetet e organizuara prej tyre me rastin e Ditës së Diplomimit, ku u ndanë çmime për nxënësit më të mirë të qytetit.
- Ofroi mbështetje për Drejtorinë Arsimore të Gramshit, Shkodrës, Lezhës, Sarandës dhe Kurbinit, gjatë aktiviteteve të tyre të organizuara me rastin e Festës së Mësuesit.
- Ofroi mbështetje për nismën e ndërmarrë për një nivel më të lartë sigurie në shkollat e mesme në Durrës dhe Korçë, duke instaluar kamerat e mbikëqyrjes në këto shkolla të mesme.

Societe Generale Albania sponsorizoi bibliotekën e brendshme të një shkolle në qytetin e Gjirokastrës.



Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit:
3,800 EUR.

OBJEKTIVI #5

Arritja e barazisë gjinore

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuara nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.
- Rritja e përqindjes së grave në Bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave të fuqinë punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

66% e stafit të **American Bank of Investments** janë femra. Bordi i **American Bank of Investments** drejtohet nga Znj. Kathryn Switek, e cila vjen nga një përvojë e gjërë në institucionet financiare ndërkombëtare.

Alpha Bank Albania është e orientuar drejt zhvillimit të aftësive të punonjësve, duke mbështetur punën sipas stileve demokratike të lidershit dhe duke synuar përfshirjen e punonjësve dhe rritjen e angazhimit ndaj zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe performancës së suksesshme në treg. Më 31 dhjetor 2016, banka kishte 415 punonjës, ku 63% ishin femra dhe 37% meshkuj. 38% e Stafit Drejtues, Menaxherëve të Divizioneve/Departamenteve dhe Menaxherëve të Degëve janë femra, sipas pozicioneve të mëposhtme:

Stafi Drejtues	25% femra
Menaxherë të Divizioneve/Departamenteve	59% femra
Menaxherë të Degëve	26% femra

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare

- Dha kontributin e saj në përmirësimin e kushteve të jetesës së grave të strehuara në Qendrën Kombëtare të Trajtit të Viktimave të Dhunës, me rastin e Festës së Gruas. Përveç donacioneve të grumbulluara nga individë përmes fushatës “Unë jam shpresë”, të lançuar në mediat sociale, Banka Kombëtare Tregtare kontribuoi në blerjen e materialeve të nevojshme për pjesën më të madhe të operacioneve ditore.
- Mbështeti aktivitetin e organizuar kundër dhunës, me fokus në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare, në shkollën “Naum Veqilharxhi” dhe në shkollën “Demokracia” në qytetin e Korçës.

Credins Bank beson fort në fuqizimin dhe rritjen e vlerave të grave. Banka promovon parimet e biznesit në favor të aplikacioneve të biznesit të grave. Gjithashtu, bazuar në politikat e saj të sponsorizimit, Banka ka ofruar vazhdimisht kontributin e saj për aktivitetet sociale dhe kulturore që promovojnë rolin e grave në shoqëri.

Banka e Parë e Investimeve Shqipëri lançoi një fushatë të brendshme për ofrimin e mundësive për karrierë dhe ndarjen e vlerave të barabarta brenda grupit, si dhe garantimin e mundësive të barabarta për të gjitha gratë dhe vajzat e reja për të ecur përpara brenda strukturave të brendshme të një shoqërie. Që nga viti 2016, **Banka e Parë e Investimeve në Shqipëri** e nisi këtë fushatë përmes mediave sociale dhe ende vazhdon ta zgjerojë më tej këtë fushatë sensibilizimi, duke përfshirë 40% të audiencës femërore drejt një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Morri pjesë në Programin e BERZH-it “Gruaja në Biznes”. Intesa Sanpaolo Bank nënshkroi një marrëveshje me BERZH-in për të qenë pjesë e një programi me prioritet të lartë strategjik të BERZH-it, duke u kthyer në një Institut Financiar Partner (“PFI”) për Programin e Grave në Biznes në Ballkanin Perëndimor, i cili u krijua me synim përkrahjen e grave në Sipërmarrjet e Biznesit mikro, të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht shumës së kufizuar të kredisë prej 2 milionë EUR, ky veprim do të shënonte një ndikim të rëndësishëm në nivel lokal.
- Banka mbështeti Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave përmes një fushate sensibilizuese, në kuadër të së cilës u shpërndanë kartolina për të gjithë punonjësit, ku përshkruheshin fakte kuçe për gratë viktime të dhunës në Shqipëri. Gjithashtu, në të gjithë rrjetin e ATM-ve të Bankës u vendos një kartolinë me sloganin e OKB-së “Bëje Botën Portokalli”, me qëllim sensibilizimin e të gjithë klientëve për këtë ditë të caktuar.

Pjesa më e madhe e stafit të **Raiffeisen Bank** janë femra, përkatësisht 75% krahasuar me 25% punonjës meshkuj. Gjithashtu, afërsisht 71% e menaxherëve janë gra. Banka ofron leje lindjeje për punonjëset e saj femra 35 ditë përpara dhe 150 ditë pas lindjes së fëmijës. Banka gjithashtu mbulon pjesën e mbetur të pagës në mënyrë që paga të mbetet po në nivelin 100% pas pagesës së ofruar nga organet e sigurimit shëndetësor dhe shoqëror, nëse nuk tejkalon shumën prej 150,000 lekë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Raiffeisen Bank sponsorizoi Linjën e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat për projektin e tyre “Për Fuqizimin e Institucioneve në Luftën kundër Dhunës dhe Diskriminimit”.

Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.

Bashkë me nismat e ndërmarra për kursimin e energjisë dhe ndikimin pozitiv në mjedis, portofoli për produktet ekologjike në sistemin bankar arriti në 42 milionë EUR.

OBJEKTIVI #7

Ensure Energy for All

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Aplikimi i ekspertizës financiare ndaj modeleve të çmimit të energjisë, të cilat përbushin tre objektivat e qëndrueshmërisë financiare, efikasitetit të energjisë dhe aksesit universale, duke përfshirë veçanërisht shqyrtimin e nevojave për energji të komuniteteve me të ardhura të ulëta.
- Nënvizimi i zhvillimeve të energjisë së rinovueshme, si për shembull plantacionet e mullinjve të erës dhe burimet e energjisë diellore për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie gjithëpërfshirëse me nivel të ulët karboni.
- Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt dhe me shërbime moderne të energjisë, rritja në mënyrë të ndjeshme e pjesës së energjisë së rinovueshme në kombinimin e energjisë së botës, dhe dyfishimi i normës globale për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania shpreh përkushtimin e saj në mbështetje të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit të shoqërive, duke përfshirë menaxhimin efektiv të dimensionit mjedisor dhe social të çdo propozimi. Kështu, gjatë vitit 2016, Banka miratoi Politikën e Menaxhimit të Riskut Mjedisor dhe Social, duke publikuar udhëzime, kushte, rregulla kredie dhe instrumente për zbatimin e këtyre rreziqeve, të lidhura ngushtë me dëmet e shkaktuara ndaj mjedisit dhe shoqërisë. Kjo Politikë kërkon që të gjitha projektet të përcaktohen, vlerësohen dhe rishikohen me fokus kundër rreziqeve të mundshme mjedisore dhe sociale në çdo fazë të procedurës së kredisë së korporatës së Grupit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania financoi projektin e energjisë së rinovueshme - Marrëveshja e rinovuar e lidhur me IFC (qershor 2016), i dha Bankës për të vazhduar dhënien e "Kredive të Gjellbra", duke përdorur kapacitetet e veta dhe duke u bazuar në trajnimet dhe ekspertizën e saj. Gjatë vitit 2016, Banka miratoi 5 projekte të reja (2 prej të cilave tashmë janë formalizuar) për ndërtimin e hidrocentraleve me fuqi totale të instaluar 54 MW.

ProCredit Bank vazhdoi të mbështesë investimet "Green" me Eko Kredi, si për klientët individë ashtu edhe për biznesin. Portofoli i Bankës Eko Kredi përbën 10, 2% të totalit të portofolit të kredive.

Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë.

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit: Mbi 10,000 EUR.

OBJEKTIVI #8

Nxitja e rritjes ekonomike dhe punës së denjë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkombëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator.
- Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime) për pronarët e bizneseve të vogla.
- Zgjerimi i financave për "të mesmen që mungon", d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin nga mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të marrin kredi nga sistemi bankar formal.
- Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me prejardhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim promovimin e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu performancën e shoqërisë përmes rritjes së diversitetit të fuqisë punëtore.
- Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare vendase për nxitjen dhe zgjerimin e aksesit në shërbimet bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

American Bank of Investments, Banka Kombëtare Tregtare dhe Union Bank morën pjesë në Panairin "Puno dhe Studio" të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Në mbështetje të sektorit të arsimit, **Banka Kombëtare Tregtare** dhe Intesa **Sanpaolo Bank Albania** morën pjesë gjithashtu në Panairin e Karrierës të organizuar në Universitetin e Nju Jorkut dhe në Panairin e Punës të organizuar nga Universiteti Evropian i Tiranës.

Banka Kombëtare Tregtare dhe **Banka e Parë e Investimeve Shqipëri** morën pjesë në Panairin e Punës të organizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ku ishin të pranishme disa nga shoqëritë më të rëndësishme në Shqipëri, të cilat ofruan mundësi punësimi për profesionistët e rinj shqiptarë.

Credins Bank

- Krijoi një bashkëpunim të fortë me institucione të ndryshme qendrore dhe vendore shtetërore në Tiranë, Fier, Korçë, lidhur me projekte të ndryshme për përmirësimin e kushteve të punës që çojnë drejt rritjes ekonomike.
- Mbështeti konkursin kombëtar "Sipërmarrësit e së nesërme" (Edicioni i 6-të) dhe "Avokatët e së nesërme" (Edicioni i 2-të), të organizuar nga Tirana Business University (TBU), me pjesëmarrjen e shumë të diplomuarve nga shkolla të ndryshme të vendit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Kreu transaksionet financiare që lidhen me vendosjen në zbatim të procesit LEA (Lehtësimi dhe Blerja e Tokave)

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

lidhur me një nga investimet më të rëndësishme në Shqipëri, Projekti i Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP). Duke marrë parasysh se shumica e njerëzve që jetojnë në fshatra, të cilët do të preken nga Projekti i TAP, hasin vështirësi financiare, Intesa Sanpaolo Bank përgatiti një paketë me produkte dhe shërbime bankare bazë me kushte preferenciale, që do të aplikohen për këtë kategori klientësh.

- Rritja e financimeve në sektorët e agrobiznesit. Banka i kushton një vëmendje të veçantë Agrobiznesit dhe gjithashtu është një nga bankat e përzgjedhura nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë që nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me BERZH-in për strukturën e Shpërndarjes së Rrezikut në Agrobiznes. Në përputhje me këtë marrëveshje, BERZH do të marrë përsipër rreziqet për kreditë e agrobiznesit nga 50% deri në 70% të humbjeve të shkaktuara. BERZH dhe Qeveria Shqiptare synojnë të ofrojnë në tërësi deri në 100 milionë EUR financime dhe instrumente për shpërndarjen e rrezikut për të ofruar mbështetje për institucionet financiare në zgjerimin e dhënies së kredive në sektorin e agrobiznesit në Shqipëri.
- Gjatë vitit 2016, baza e të dhënave të klientëve u pasurua dhe u organizuan disa seminare dhe takime në grup në qytete të ndryshme, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm si: Creative Business Solutions (CBS), një OJQ e mbështetur nga USAID, OJQ-të lokale të Grave Sipërmarrëse dhe Artizanëve nga Shkodra, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Lokal (AULEDA) Vlorë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore, autoritetet vendore dhe Drejtoritë e Bujqësisë në qytetet kryesore, si dhe dhomat e ndryshme të tregtisë. Objektivat kryesore të theksuara gjatë këtyre takimeve ishin rritja e ndërgjegjësimit mes agrobizneseve, me fokus të veçantë në mundësitë e marrjes së granteve të BE-së dhe kredive fleksibël të ofruara nga Banka.

ProCredit Bank beson se bashkëpunimi rajonal është në fokusin e Bankave ProCredit, ndaj dhe, me iniciativën dhe ftesën e marrë nga ProCredit Holding, aksionari i vetëm i ProCredit Bank në Shqipëri, mbi 500 biznese nga rajoni morën pjesë në aktivitetin B2B, të organizuar në Selanik, Greqi. Theksi u përqendrua në nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet bizneseve që operojnë në vende të ndryshme të rajonit: Shqipëria, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Serbi, Bullgari, Moldavi, Gjeorgji, etj. duke krijuar mundësi reale për t'u lidhur me partnerë të mundshëm në biznes.

ProCredit Bank dhe **Societe Generale Albania** mbështetën zhvillimin e agrobizneseve përmes AGROFIN, i parashikuar në bashkëpunim me BERZH-in. Qëllimi i këtij fondi është nxitja e dhënies së kredive ndaj NVM-ve në nevojë për investime, me mbështetjen financiare të BE-së.

Në prill të vitit 2016, **Societe Generale Albania** u bë pjesë e Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e NVM-ve. Programi synon të mbështesë këto biznese në projektet e tyre investuese për blerjen e makinerive, pajisjeve dhe shërbimeve me origjinë italiane. Ky është një program i përbashkët i qeverive italiane dhe shqiptare për të mbështetur kreditë me interes të ulët për bizneset e vogla dhe të mesme shqiptare, me qëllim nxitjet e zhvillimit të mëtejshëm. Ky Program financohet nga Qeveria Italiane.

Veneto Banka mori pjesë në veprimtarinë e organizuar nga shoqata "Albalaureati", Fondacioni IIDS dhe Ambasada Italiane në Tiranë, duke mbështetur të rinjtë shqiptarë që kanë përfunduar studimet e tyre në Universitetet Italiane.



Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit: Mbi 230,000 EUR.

OBJEKTIVI #9

Ndërtimi i infrastrukturave, nxitja e inovacionit

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.
- Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).
- Rritja e aksesit të ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përbalueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Në kuadër të përmirësimit të bashkëpunimit me partnerët e saj të biznesit, **Alpha Bank Albania** organizoi një raund takimesh në qytetet kryesore të Tiranës, Korçës, Elbasanit, Fierit, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Beratit dhe Shkodrës, ku pjesëmarrësit u njohën me misionin dhe vizionin e Bankës, për të përmirësuar vazhdimisht produktet dhe shërbimet e ofruara në përputhje me nevojat e klientëve dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Duke përqafuar si gjithmonë të gjitha trendët inovative që u vijnë në ndihmë jetës së njerëzve, **Banka Kombëtare Tregtare** sponsorizoi pjesërisht Javën e Inovacionit Dixhital, një aktivitet i organizuar nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, me qëllim prezantimin dhe promovimin e përdorimit të zgjidhjeve inovative në shërbimet publike. Ky aktivitet do ta njohë komunitetin me pajisjet e ofruara nga teknologjitë e reja dhe përdorimin e tyre në shërbimet publike.

Credins Bank, në përputhje me objektivat e saj, ka investuar dhe hartuar politika për të mbështetur financimin e projekteve të qëndrueshme në fushën e industrisë dhe inovacionit, duke mundësuar pajisje, programe kompjuterike dhe sisteme, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së këtyre institucioneve.

ProCredit Bank

- Për herë të parë në Shqipëri, kjo Bankë prezantoi depozitat në ATM, një shërbim bankar që ofrohet zonat 24/7. Këto zona unike ofrojnë depozita, tërheqje, transfera, pagesa etj. si për klientët individë ashtu edhe për biznesin. Transaksionet në këto zona janë më të lira dhe të disponueshme jashtë orarit zyrtar të punës së bankës.
- Ofroi mbështetje për seminarin "Sfidat e zhvillimit rajonal" të organizuar në Shkodër, në Universitetin

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

“Luigj Gurakuqi”. ProCredit shpërndaq çmime për 3 studentët e parë që sollën idetë më inovative.

- Në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, projekti IDEA (Zhvillimi i Inovacionit për Sipërmarrësit në Shqipëri) u ofroi 120 bizneseve të reja një mundësi unike për të forcuar dhe fuqizuar aftësitë sipërmarrëse dhe të biznesit, zhvillimin e karakteristikave personale të sipërmarrësve të nevojshme për gjenerimin e ideve dhe finalizimin e një plani biznesi bindës. ProCredit Bank ofroi një kombinim trajnimesh dhe këshillimi/drejtimi. Banka

ishite një partner strategjik që ndau përvijën e saj dhe strategjitë e “know-how” me aplikantët, duke u ofruar edhe këshillim lidhur me shërbimet financiare dhe bankare për sipërmarrësit e rinj, me qëllim ndërtimin dhe zhvillimin e bizneseve të tyre të reja.

- Morri pjesë në një aktivitet B2B të zhvilluar në Tiranë, ku ishin të pranishëm shumë biznese të industrisë ushqimore nga mbarë vendi. Fokusi i këtij aktiviteti ishte dhënia e një kontributi të prekshëm në zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit që operon në këtë industri, përmes promovimit të produkteve të tyre lokale.

Më 20-22 maj, **Societe Generale Albania** mori pjesë si sponsor “Diamond” në edicionin e 5-të të “Start-up live Tirana”. Start-up live Tirana është një aktivitet që mbledh së bashku studentë të shumtë të ndarë në ekipe që ofrojnë, eksplorojnë dhe zhvillojnë ide të reja për qëllimin e vetëm të prezantimit të risive në tregun shqiptar.

Me rastin e Ditës së Evropës, më 9 maj, **Tirana Bank** së bashku me partnerët e saj organizuan aktivitetin «EU TRANSIT» në sheshin «Nëna Tereza». I konceptuar si një aeroport, me 4 terminale, përkatësisht: Agro-Turizmi, Arti dhe Kultura, Teknologjia dhe Inovacioni, Komunikimi dhe Perceptimi, sheshi u shndërrua në një arenë për shkëmbimin e ideve, duke promovuar potencialet dhe vlerat më të mira të Shqipërisë. «Inkubatori i Biznesit» u vendos në qendër të sheshit, ku 10 të rinj prezantuan idetë e tyre si sipërmarrës. Pesë nga këto projekte u vlerësuan me çmim si fitues dhe do të mbështeten financiarisht si pionierë të integritit dhe pionierë të biznesit.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Kombëtare Tregtare

- Sponsorizoi rindërtimin e pjesshëm të ndërtesës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, e cila do të mundësojë kushte më të mira pune për punonjësit, të cilët janë përgjegjës për një mision kaq të rëndësishëm dhe kritik ndaj njerëzve në nevojë.
- Dhuroi disa pajisje zyre për Bashkinë e Peshkopisë për përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve, duke sjellë kështu një efektivitet më të lartë dhe shërbime më cilësore të ofruara ndaj komunitetit të Peshkopisë.
- Bëri të mundur dhurimin e mobilieve të reja të zyrës për Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës të personave të punësuar në këtë institucion.
- Ofroi mbështetje për Portin Detar të Vlorës me dhurimin e disa mobilieve për zyra, duke përmirësuar vendin e punës dhe kushtet e punës të punonjësve.
- Dhuroi disa mobilie zyre për Bashkinë e Selenicës, duke sjellë kushte më të mira për vendin e punës, me

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

- qëllim ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.
- Ofroi mbështetje për Drejtorinë Lokale Bujqësore, Shkodër, duke dhuruar disa pajisje zyre që do të ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të punës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore, të cilat konsiderohen si thelbësore për një sektor kaq të rëndësishëm në vendin tonë.
- Ofroi mbështetje financiare për Drejtorinë Lokale të Bujqësisë në Elbasan, për organizimin e një aktiviteti me rastin e fundit të vitit 2016. Ky aktivitet gjithashtu është një rast i mirë për të vendosur marrëdhënie midis Bankës Kombëtare Tregtare dhe fermerëve lokalë, të cilët morën pjesë në këtë aktivitet.
- Mbështeti rindërtimin e pjesshëm të ndërtesës së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës të personave të punësuar në këtë institucion.
- Sponsorizoi prokurimin e një pajisjeje telekomunikacioni të nevojshme për Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë Krujë për lehtësimin e disa operacioneve ditore.
- Dhuroi kompjuterë dhe fotokopje për Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit të Gjirokastrës, duke përmirësuar efektivitetin e përditshëm të operacioneve të tyre dhe duke ofruar shërbime më të mira dhe më të shpejta për komunitetin.
- Dhuroi disa pajisje zyre për Drejtorinë Arsimore të Delvinës, duke lehtësuar dhe përmirësuar kushtet e tyre të punës.
- Sponsorizoi disa pajisje të nevojshme për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), duke kontribuar për arritjen e kushteve më të mira të punës.
- Dhuroi disa pajisje zyre për Institucionin e Shëndetit Publik, duke lehtësuar dhe përmirësuar kushtet e tyre të punës.
- Sponsorizoi rikonstruksionin e parkut jashtë institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në Vlorë.
- Sponsorizoi zbulimet për pemën e Vitit të Ri, të vendosur në Spitalin Universitar Gjinekologjik Obstetrikë “Koço Gëlozheni”, duke krijuar një atmosferë festive me rastin e festave të fundit të vitit 2016.
- Sponsorizoi rikonstruksionin e parkut që rrethon institucionin e Fabrikës së Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në Pashaliman - Vlorë.
- Ofroi mbështetje financiare për Shoqatën “Qyteti shqiptar” i Krujës për organizimin e një aktiviteti me rastin e fundit të vitit 2016.

Credins Bank sponsorizoi Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, duke financuar blerjen dhe shpenzimet e disa pajisjeve. Këto pajisje do të ndihmojnë në krijimin e një ambienti më të mirë dhe më produktiv të punës.

Raiffeisen Bank

- Banka financoi rikonstruksionin e dhomave të pritjes në stacionin e policisë në Lushnjë. Këto ambiente të rinovuara do të ofrojnë kushte moderne dhe standarde më të larta për qytetarët.
- Raiffeisen Bank dhe Bashkia e Tiranës kanë pasur një bashkëpunim të ngushtë në ndërtimin e pesë këndeve të lojërave për të përmirësuar jetën e komunitetit në tërësi, jo vetëm jetën e fëmijëve dhe prindërve;
- Bashkia e Pogradecit përfitoi mbështetjen e Raiffeisen Bank për të bërë të mundur rindërtimin e parkut të qytetit;
- Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit të Sarandës përfitoi disa fonde për mobilim për t’i ardhur në ndihmë punonjësve për ta pasur më të lehtë ofrimin e një shërbimi më të mirë për qytetarët;
- Banka i erdhi në ndihmë Drejtorisë Arsimore të Beratit duke sponsorizuar projektin «Informatizimi i shkollave».
- Sponsorizoi Burgun e Tepelenës për rindërtimin e ambienteve të brendshme të institucionit.
- Mbështeti Bashkinë e Beratit duke bërë të mundur rindërtimin e kopshteve për fëmijë në Berat.
- Mbështeti rikonstruksionin e fasadës së bibliotekës «Marin Barleti» në Shkodër, në përputhje me kërkesën e Bashkisë së Shkodrës.
- Sponsorizoi Bashkinë e Kavajës për rinovimin dhe pajisjen e dy kopshteve për fëmijë.
- Mbështeti Shoqatën «Miq për Jetën» për rindërtimin e një fushe tenisi në Shkollën Vasil Shanto.

OBJEKTIVI #10

Ulja e pabarazive

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përdorimi i teknologjive të reja të tilla si shërbimet e pagesave të parave të lëvizshme për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efikase dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.
- Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika “cloud” për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.
- Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.
- Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

American Bank of Investments sponsorizoi darkën gala “Promovimi i Ndryshimeve, Mbështetja e Progresit”. Misioni i këtij aktiviteti ishte grumbullimi i fondeve për mundësimin e vazhdueshëm të akomodimit, ushqimit, mbështetjes psiko-sociale, trajnimeve gjatë gjithë jetës, arsimit dhe punësimit për të rinjtë LGBT, të cilët jetojnë pranë Qendrës “Streha” dhe janë viktime të abuzimit dhe diskriminimit.

Banka Ndërkombëtare Tregtare, Credins Bank dhe **Tirana Bank** janë përkushtuar të vazhdojnë «adoptimin» e disa fëmijëve nga fshati SOS. Sponsorizimi i jetës së këtyre fëmijëve është një bashkëpunim afatgjatë që mundëson mbështetje të përhershme për këta fëmijë.

Në kuadër të nxitjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri, Departamenti i Burimeve Njerëzore të **Intesa Sanpaolo Bank Albania**, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, gjatë muajit qershor 2016 vendosi të organizojë një trajnim me pjesëmarrjen e rreth 45 kolegëve nga Elbasani, Shkodra dhe Vlora. Banka është institucioni i parë jo publik në Shqipëri që organizon një trajnim të kësaj natyre. Gjatë vitit 2016, Banka mbështeti nismat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër dhe në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Banka punësoi tre punonjës që i përkasin kësaj kategorie (dy në Degën e Vlorës dhe një në Degën e Elbasanit).

Banka e Parë e Investimeve Shqipëri organizoi një fushatë gjithëpërfshirëse sensibilizuese ku qëllimi kryesor ishte puna e përbashkët për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në një botë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që mirëpret njerëzimin me gjithë diversitetin e tij.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

NBG Bank Albania iu përgjigj pozitivisht kërkesës së drejtuar nga Koordinator i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe UNDP për të mbështetur një aktivitet për mbledhjen e fondeve dedikuar personave me aftësi të kufizuara, duke blerë bileta për stafin e saj.

Gjatë vitit, Banka **Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, NBG Bank Albania, Raiffeisen Bank, Union Bank** mbështetën aktivitete të ndryshme të “Down Syndrome Albania”, e cila është e vetmja shoqatë në Shqipëri që ofron terapi dhe shërbime të tjera pa pagesë për fëmijët me sindromën “down”.

Union Bank, si sponsor zyrtar i ekipit kombëtar të futbollit, vazhdon të promovojë marrëdhëniet me komunitetin e biznesit, duke u ofruar biznesmenëve bileta për ndeshjen e parë kualifikuese të Kampionatit Botëror 2018.



OBJEKTIVI #11

T'i bëjmë qytetet në vendbanime të qëndrueshme

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Vendosja e bashkëpunimit me palët e interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastrukture dhe transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.
- Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofroi stimuj për zbatimin e tyre.
- Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.
- Përforsimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.
- Sigurimi i aksesit universal në hapësira të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania sponsorizoi rindërtimin e sallës së mbledhjes së Bashkisë Librazhd. Përveç riparimit dhe rinovimit të infrastrukturës së ndërtimit (d.m.th. mure, dysheme, dritare dhe dyer), mbështetja e Bankës përfshinte edhe rikonstruktimin e rrjetit ekzistues elektrik, telefonik dhe të internetit.

American Bank of Investments

- Gjatë sezonit të verës, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, banka mbështeti organizimin e një sërë aktiviteteve promovuese për zhvillimin e turizmit në disa qytete: Saranda "Hapja e Sezonit Turistik 2016", aktiviteti "Boulevard Fest" në Kavajë i organizuar nga artistët e rinj të qytetit, «Festa e Birrës 2016» në Korçë dhe «Verë dhe Portokall» në Gjirokastrë.
- Në nëntor, Banka sponsorizoi «Mr. & Mrs Invest in Bazar», e cila u organizua në Pazarin e Korçës, me qëllim

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit, si dhe për nxitjen e bizneseve për të investuar në këtë hapësirë unike për sa i përket arkitekturës dhe potencialit të zhvillimit.

Banka Kombëtare Tregtare sponsorizoi pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Entit Kombëtar të Banesave në konferenca të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat janë vendimtare për asimilimin e standardeve të reja evropiane të lidhura me çështjet e strehimit dhe zbatimin e këtyre standardeve në Shqipëri.

Credins Bank

- Banka sponsorizoi Entin Kombëtar të Banesave në Konferencën e Federatës Evropiane të Strehimit, me qëllim informimin e mëtejshëm dhe edukimin e komunitetit.
- Mbështeti Bashkinë e Tiranës, duke sponsorizuar materiale kufizuese dhe pllaka betoni, si dhe gërmimin e tokës dhe mbushjen me rërë, për ndërtimin e një këndi lojërash reaktiv në Tiranë.
- Sponsorizoi rikonstruksionin e Zyrës Vendore të Pogradecit dhe blerjen e disa materialeve ndërtimi, një investim në dobi të një infrastrukture më funksionale dhe bashkëkohore.
- Ofri mbështetje financiare për Bashkinë e Kavajës, për izolimin dhe sistemet e ngrohjes në institucionet për kujdesin e fëmijëve, veçanërisht në kopshte, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe kushteve të akomodimit të fëmijëve.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti Bashkinë e Korçës për krijimin e projektit të hartës së qytetit dhe gjithashtu ofroi mbështetje edhe për Konsullatën Italiane të Vlorës për organizimin e aktivitetit "Festa della Repubblica".

NBG Bank Albania

- Banka ofroi mbështetjen e saj për rindërtimin e katedrales së Shën Dhimitrit në Berat.
- Çdo verë, shoqata "Dëshmorët e Policisë së Shtetit" organizon kampe verore për fëmijët e policëve të rënë në detyrë. Banka e mbështeti këtë nismë duke sponsorizuar pushimet për 100 fëmijë në këto kampe verore.
- Çdo verë, Qendra Kulturore e Fëmijëve "Mihal Grameno" në Korçë organizon Festivalin e Këngës për Fëmijë. Këtë vit, NBG Bank në Shqipëri sponsorizoi edicionin e 49-të të këtij Festivali.
- Si pjesë e angazhimit të saj, banka vazhdoi të ofrojë mbështetje për artistët e rinj dhe kontributet e tyre në artin dhe kulturën shqiptare. "Pushteti i karriges" është një performancë koreografike e vënë në skenë si shprehje e metamorfozës së individit në kërkim të pushtetit. Kjo shfaqje baleti u vu në skenë në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit për tre ditë radhazi.
- Çdo vit, Qyteti i Kavajës organizon «Boulevard Fest», një aktivitet i rëndësishëm veror për këtë qytet. Banka mbështeti këtë aktivitet, duke qenë një nga sponsorët e tij.
- Në lidhje me përkushtimin e saj në mbështetje të sistemit arsimor në Shqipëri, Banka dhuroi një sistem audio të kompletuar dhe lap-top për Shkollën «1 Maji», të cilat do të përdoren për aktivitetet e nxënësve.
- Banka sponsorizoi «My name is Balkan», një festival arti që organizohet çdo vit në Tiranë. Festivali prezantoi disiplina të ndryshme të artit të pranishme në territorin e Ballkanit, duke e transformuar Tiranën në një pikë referimi të rëndësishme për vlerat kulturore të zonës ballkanike.
- Kontribuoi në restaurimin e ndërtesës «Seferis», e cila ndodhet në Korçë. Ndërtesa e mrekullueshme neoklasike në qendër të Korçës ishte shtëpia e poetit grek George Seferis gjatë viteve 1936-1937, kur ai shërbeu në detyrën e Konsullit të Përgjithshëm të Greqisë.

Raiffeisen Bank

- Mbështeti Komandën Detare të Durrësit për ndërtimin e rrugës dhe sheshit përpara këtij institucioni.
- Mbështetja për Bashkinë e Fierit për rikonstruksionin e ndërtesës.
- Mbështetur Bashkinë e Sarandës për rindërtimin dhe rehabilitimin e shëtitores, përmes krijimit të veprave të artit dhe skulpturës.
- Mbështeti Forumin e Mendimit të Lirë duke sponsorizuar aksionin e pastrimit në Gjirin e Lalzit, Vlorë, Shëngjin, etj. Punonjësit e bankës morën pjesë vullnetarisht në këtë aksion pastrimi.

Societe Generale Albania mbështeti Bashkinë e Korçës me ofrimin e ndihmës së saj për krijimin e një hartë të qytetit, duke nxjerrë në pah të gjitha vendet e mundshme turistike për vizitorët shqiptarë ose të huaj në këtë qytet. Kjo hartë synon zhvillimin e turizmit në Korçë.

OBJEKTIVI #12

Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jetë më të qëndrueshme.
- Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit efikas të burimeve natyrore.
- Ulja në mënyrë thelbësore e prodhimit e mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.
- Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqëritë e mëdha dhe ndërkombëtare, për adaptimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.
- Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Stafi drejtues përgjegjës për zinxhirin e furnizimit. **Intesa Sanpaolo Bank Albania** tashmë është pjesë e Centralizimit të Prokurimeve, duke zbatuar standardet e Grupit ISP; projekti gjithashtu propozon sensibilizimin e mëtejshëm për çështjet e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore. Gjithashtu, shtojca lokale për Manualin e Prokurimit, Përgjegjësia Sociale e Korporatave të Furnitorëve, është një tjetër kërkesë shtesë për promovimin e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore te furnitorët. Si një nga praktikave më të mira, mund të përmendim tenderin në lidhje me furnizimet e artikujve të kancelarisë, ku pjesëmarrësit u ftuan të plotësonin një pyetësor për Përgjegjësinë Sociale. Gjithashtu, furnitorëve iu kërkua që të dorëzonin certifikatën e origjinës për produktet e përdorura.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Sipas dokumenteve të dorëzuara nga furnitori aktual i artikujve të kancelarisë dhe bazuar në informacionet e dhëna nga prodhuesit, mallrat ishin në përputhje me standardet ISO: 9001 (Menaxhimi i cilësisë) dhe 14001 (Sistemi i menaxhimit mjedisor). Përveç kësaj, bazuar në informacionin e grumbulluar, se letra A4 e përdorur për printim është prodhuar në përputhje me Menaxhimin e Përgjegjshëm të Pyjeve.

Nga data 1 dhjetor 2016, klientët e **Intesa Sanpaolo Bank Albania** i kanë krye operacionet e tyre bankare në ambientet e reja dhe shumë moderne të Degës Kryesore. Njëkohësisht, u mundësuan hapësira të reja pune shumë funksionale për të gjithë punonjësit e punësuar në zyrat qendrore. Projekti i rimodelimit të zyrave qendrore dhe degës kryesore u vendos për herë të parë në zbatim në nëntor 2015, u finalizua në dhjetor 2016, dhe do të vijojë më tej me rimodelimin e degës që ndodhet në Rr. Barrikadave. Ambientet e zyrave qendrore u rikonstruktuan sipas një dizajni bashkëkohor, me tavan industrial që mundëson një hapësirë më të lartë të mjedisit të brendshëm, duke i dhënë ambientit të punës më shumë ajër dhe hapësirë. Ndrërimi me LED dhe sistemi i ajrit të kondicionuar u rinovua plotësisht dhe tani ofron mundësinë e ndryshimit të kontrollit të temperaturës në secilin prej ambienteve; gjithashtu, janë instaluar edhe sisteme që mundësojnë kursimet e energjisë. Në këtë projekt, Intesa Sanpaolo Bank në Shqipëri ka qenë në përputhje me të gjitha rregullat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit, sipas konceptit “Ekologjik”.

Bazuar në bashkëpunimin për riciklimin ekologjik dhe raportin vjetor të saj, **Banka Ndërkombëtare Tregtare** ofroi kontributin e saj pozitiv në mjedis, si vijon:

duke ricikluar 588 kg mbetje të letrave, **Banka Ndërkombëtare Tregtare** bëri të mundur shmangien e shkarkimit të CO2 për rreth 0,8 ton letër dhe gjithashtu arriti të kursente sa vijon:

- 11 pemë
- 21.5 metra kub ujë
- 2,410 kW energji
- 5.3 fuçi naftë
- 16 kg ndotës ajri
- 2 metra kub hapësirë në landfill

ProCredit Bank vijoi me zbatimin e plotë të konceptit të Sistemit të Administrimit të Mjedisit në Shqipëri. Si rezultat i masave të brendshme, gjatë vitit 2016, ProCredit Bank në Shqipëri reduktoi nivelin e konsumit në kushte absolute, krahasuar me vitin e mëparshëm:

- Konsumi i energjisë elektrike me 12%
- Konsumi i letrës me 21%
- Konsumi i ujit me 8%
- Konsumi i lëndës djegëse për transport me 17%

Raiffeisen Bank është përfshirë gjerësisht në fushatën sensibilizuese për projektin “Eliminimi i letrës” (Paperless). Janë ndërmarrë hapa praktikë dhe aktualë për të zvogëluar në mënyrë drastike përdorimin e letrës. Degët kanë përdorur një format të ri për të printuar transaksione me para në dorë dhe për të eliminuar printimet e disa dokumenteve në proceset me para në dorë. Po testojmë mos lëshimin e faturës në disa ATM, ku printimi i faturës është kthyer në zgjedhje opsionale për të kursyer letrën dhe për t'u dhënë të gjithë klientëve mundësinë që të mendojnë në mënyrë ekologjike përpara se të printojnë. Printimi nga të dyja anët e letrës është zbatuar plotësisht gjatë vitit 2016 dhe do të vazhdojë të zbatohet edhe gjatë vitit 2017.

OBJEKTIVI #13

Lufta kundër ndryshimit klimatik

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Investime në – dhe/ose rritje të financimit për – zbutjen e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.
- Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.
- Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe Union Bank mbështetën projektin Ecovolis, i cili synon sensibilizimin e qytetarëve dhe komunitetit të Tiranës për përdorimin e biçikletave për nevojat e tyre të përditshme, duke ndihmuar në lehtësimin e mbingarkesës dhe zvogëlimin e shkarkimit të karbonit, duke kontribuar gjithashtu në rritjen e nivelit të aktivitetit fizik të qytetarëve për përmirësimin e cilësisë së jetës.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Raiffeisen Bank

- “Eco Fashion Show” është në tjetër projekt ekologjik që sektori bankar ka mbështetur që nga viti 2012. Qëllimi është të rrisë ndërgjegjësimin dhe të frymëzojë kreativitetin ekologjik, duke përfshirë fëmijët, artiste dhe sipërmarrës të shkollave në një shfaqje mode me veshje kreative të krijuara vullnetarisht nga secili prej tyre.
- «Live Eco, Celebrate Eco» është një ngjarje e organizuar me rastin e Ditës së Verës dhe ka të bëjë me zhvillimin e një feste të mjedisit të periudhës më të lulëzuar të vitit që është stina e pranverës dhe verës.

Societe Generale në Shqipëri përkrahu nismën e lyerjes së trungjeve të pemëve, për të dëshmuar kujdesin e mirë.

OBJEKTIVI #15

Jeta në Tokë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përdorimi i metodave inovative financiare për të mbledhur fonde, me qëllim ruajtjen e pyjeve dhe ekosistemeve.
- Promovimi i ndarjes sa më të drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike, dhe promovimi i aksesit së duhur në këto burime, në përputhje me standardet e vendosura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar.
- Mobilizimi i rezervave nga të gjitha burimet dhe nivelet, për të financuar administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ofrimin e stimujve të mjaftueshëm për vendet në zhvillim, për përparimin e një administrimi të tillë, duke përfshirë ruajtjen dhe pyllëzimin.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Në kuadër të Ditës Vullnetare në Grup të organizuar nga **Alpha Bank**, për të tetin vit radhazi, më 22 maj dhe 5 qershor, 2016, u organizuan dy aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e 210 punonjësve të bankës, me qëllim pastrimin e plazhit të Kepit të Rodonit dhe mbjelljen e pemëve në Lurë.

Credins Bank

- Ka luajtur një rol kyç në mbështetje të Bashkisë së Tiranës për sa i përket përmirësimit të planifikimit urban dhe mbështetjes ndaj komunitetit, për zhvillimin e parqeve dhe zonave të gjelbra me mbjelljen e 100 bimëve të llojit Oleandër.
- Promovoi Ditën Botërore të Jetës së Egër duke mbështetur krijimin e një spoti promociional për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë së njerëzve ndaj saj.

Dita Botërore e Mjedisit! ZERO TOLERANCE për tregtinë e paligjshme të kafshëve të egra “Mbroni kafshët e egra - mbroni jetën”. (WED) është dita më e rëndësishme e Kombeve të Bashkuara për nxitjen e sensibilizimit dhe veprimeve në mbarë botën, për mbrojtjen e mjedisit tonë. **Intesa Sanpaolo Bank**, si çdo vit, promovon këtë ditë të veçantë! Audiencia e synuar përfshinte të gjithë punonjësit e Bankës dhe klientët të cilët përdorin ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank.

Stafi i **ProCredit Bank** ka ndërmarrë një nismë vullnetare për pastrimin e disa zonave të ndryshme në plazhin e Shëngjinit, në qytetin e Lezhës dhe në pjesën turistike të Korçës. Përmes këtij aksioni, ata kishin si qëllim të siguronin më shumë hapësira publike për qytetarët dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Nxitja e shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe përfshirëse në të gjitha nivelet.

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit: Mbi 23,000 EUR.

OBJEKTIVI #16

Promovimi i Drejtësisë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunimi me investitorë të tjerë institucionalë për çështje të reja apo të diskutueshme, për promovimin e biznesit të përgjegjshëm në zonat me rrezik të lartë, duke siguruar që shoqëritë investuese të shohin një korrelacion të qartë mes biznesit të përgjegjshëm, disponueshmërisë, dhe çmimit të kapitalit.
- Promovimi i shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë.
- Ulja thelbësore e korrupsionit dhe ryshfetit në të gjitha format e tyre. Sigurimi i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet. Përhapja dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

American Bank of Investments mbështeti Komisionarin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale për organizimin e Konferencës së Dytë Kombëtare “Mbi të drejtën për informim/pyetje.al”. Gjatë këtij aktiviteti, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, vendore dhe të drejtësisë nga i gjithë vendi, u vlerësua zbatimi i ligjit “Për të drejtën e informimit” nga ana e autoriteteve publike. Ky bashkëpunim mes Bankës dhe Komisionarit u shtri dhe në konferencat rajonale për të drejtat e informacionit, të zhvilluara në qytetet Elbasan, Vlorë, Kukës, Sarandë, Berat, Shkodër dhe Korçë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Gjatë vitit 2016, fusha e sportit dhe artit kanë përbërë një pjesë të konsiderueshme të politikave mbështetëse të **Credins Bank** që kanë ndikuar dhe kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës së klubeve sportive dhe zhvillimin e aktiviteteve artistike, si një domosdoshmëri për krijimin e institucioneve më efektive.

Tirana Bank mbështeti Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademinë e Policisë duke kontribuar në pajisje zyre, si laptop-ë dhe kompjuterë. Për këtë arsye, Tirana Bank po zgjeron përpjekjet për të vendosur rend dhe rregull në komunitet, si dhe përmes kontributeve të saj në Policinë e Shtetit.

Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.

Kontributi nga sistemi bankar përgjatë gjithë vitit: Mbi 100,000 EUR.

OBJEKTIVI #17

Forcimi i Mënyrave të Vënies në Zbatim

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.
- Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së Shërbimeve Financiare të përafuara me OZHQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato qëllime, për optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.
- Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politik bërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Credins Bank

- Ofroi një mbështetje shumë të vlefshme për Dhomën Britanike të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administratës. Kjo mbështetje ka për qëllim krijimin e një platforme për nxitjen e prodhuesve të Agrobiznesit në vendosjen e prioritetve të zhvillimit të biznesit dhe mënyrat për të shtuar vlerën e produkteve të tyre, ndërsa janë në kërkim të tregjeve të reja. Banka gjithashtu ofroi zgjidhje financiare dhe paketa sigurimi për bizneset pjesëmarrëse.
- Mbështeti financiarisht “Partners Albania” për organizimin e konkursit kombëtar “Ide të Gjelbra 2016”. Konkursi synon të mbështesë iniciativat e biznesit që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin, punësimin dhe zhvillimin ekonomik lokal përmes një qasje miqësore ndaj mjedësit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti konferencën “Reforma e Drejtësisë, një para-kusht kryesor për nxitjen e investimeve të huaja”, e organizuar nga FIAA në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri. Investitorët e huaj e vlerësojnë miratimin e Reformës në Drejtësi në Shqipëri, e cila është konsideruar si një nga kushtet më të rëndësishme që do të siguronte qëndrueshmërinë e investimeve të tyre në vend.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

American Bank of Investments

- Mbështeti projektin e AIDA (Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve) për implementimin e dy broshurave "Shqipëria bën Thirrje", të cilat u japin investitorëve të huaj informacion të hollësishëm mbi kushtet dhe avantazhet e zhvillimit të biznesit në Shqipëri dhe ofrojnë një pasqyrë të të gjitha ekonomive dhe potencialeve industriale në vend.
- Bashkëpunoi me Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale 302, duke mbështetur financiarisht projektin për përmirësimin e infrastrukturës kompjuterike dhe logjistike për institucionet e drejtësisë, një pjesë e domosdoshme për të pasur institucione efektive.
- Mbështeti Dhomën Amerikane të Drejtësisë në organizimin e disa prej aktiviteteve më të rëndësishme të saj, duke qenë partner në të njëjtin mision promovimi të vlerave të përbashkëta shqiptare dhe amerikane. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Banka Amerikane e Investimeve ishte sponsori Platin i Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Amerikane edhe në organizimin e festimeve me rastin e 4 korrikut, Festës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara.

Banka Kombëtare Tregtare, për të dytin vit radhazi, financoi dhe organizoi tryezën e rrumbullakët shqiptare "Progresi i Shqipërisë drejt rritjes të shpejtë të ekonomisë në Ballkan për 2017" në Forumin Qendror dhe Lindor të Euromoney, me pjesëmarrjen e Ministrit të Financave Z. Arben Ahmetaj, Zëvendës-Guvernatores së Parë Zj. Elisabeta Gjoni, Presidentit të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim Z. Ihsan Ugur Delikanli dhe Drejtorit Ekzekutiv të BKT dhe anëtarit të bordit Z. Seyhan Pencablgl. Ky forum mbledhi së bashku banorët qendrorë të rajonit, ministrat e financave dhe personalitetet e tjera kryesore në fushën e politikës, ekonomisë dhe financave.

Credins Bank ofroi mbështetje logjistike në organizimin e Konferencës së CEST-IT në 2016, nga Shoqata CESTIRA. Konferenca synonte të kërkonte konvergencën e ekonomisë shqiptare me ato të Ballkanit Perëndimor, dhe mënyrën se si ato të gjitha janë në përputhje me ekonominë evropiane. Në këtë hulumtim u përdorën faktorë të ndryshëm përveç PBB, për përshkrimin e zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

Gjatë vitit 2016, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** synoi rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë të punësuarve në lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. I gjithë stafi u informua për të 17-të objektivat dhe u ftua për të shprehur idetë e tyre për t'u angazhuar vullnetarisht në ndërmarrjen e disa veprime konkrete në datat e zgjidhjes së tyre. Në këto ditë të veçanta, disa kartolina tematike u shpërndanë brenda stafit.

Raiffeisen Bank i ofron mbështetje të përvitshme Ambasadës Austriake për të gjitha aktivitetet kulturore të organizuara në Tiranë dhe qytete të tjera, si edhe për festimin e Ditës Kombëtare të Austrisë.

Societe Generale Albania

- Në datat 8-9 maj Societe Generale Albania, në bashkëpunim me Fondacionin Kulturor "Evropa", organizoi Festimin e Koncertit të Evropës.
- Në cilësinë e sponsorit të përgjithshëm, përkrahu Festivalin Ndërkombëtar Operistik "Maria Kraja", i cili u organizua më 4-5 nëntor, 2016.
- Ashtu si çdo vit, shndërruar tashmë në një traditë, Societe Generale Albania mbështeti organizimin e Pranverës Frankofone më datat 17-24 mars, në rolin e mbikëqyrësit në këtë mision kulturor të Aleancës Franceze dhe mbikëqyrës i ekspozitës që ekspozon disa nga ngjarjet më të famshme të këtij edicioni. Banka gjithashtu mbështeti ekspozitën me karikatura nga disa artistë nga e gjithë Evropa, një shfaqje në Teatrin Metropolitan, e cila u vu në skenë nga një trupë Franceze, etj.
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Banka organizoi edicionin XI të "Chamber Fest" në Durrës. Ky aktivitet u organizua në ambientet e Muzeut Arkeologjik të Durrësit.
- Shndërruar tashmë në traditë, në maj të 2016, Societe Generale Albania i dhuroi Shkollës Ndërkombëtare Franceze disa artikuj shkollorë. Dhurimi i këtyre artikujve shkollorë përkoi me festimin e përfundimit të vitit shkollor të organizuar në ambientet e shkollës.

SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS

ARTI, SPORTI & KULTURA

Gjatë 14 – 17 tetor 2016, Guitar Foundation Albania, mbështetur nga **Alpha Bank Albania**, organizoi edicionin e 4-të të Festivalit të Kitarës në Tiranë.

American Bank of Investments

- Ishte sponsori zyrtar për vitin 2016, për aktivitetet e Qendrës Kulturore të Tiranës dhe Teatrit Metropolitan. Banka Amerikane e Investimeve është krenare për kontributin a saj modest për përmirësimin e kushteve dhe hapësirave të jetës artistike në kryeqytet dhe më gjerë.
- Është sponsori kryesor i të gjitha skuadrave sportive të Klubit Sportiv “Studenti”.
- Ishte sponsori kryesor i një projekti interesant, i cili u zhvillua në kryeqytet gjatë muajve të verës, i cili mundësoi për të gjithë të pasionuarit e filmit të ndiqnin filma falas.
- Mbështeti financiarisht koncertin e Dua Lipa, këngëtares së famshme shqiptare.
- Mbështeti teatrin “Nata Arabe” në Teatrin Metropol.
- Mbështeti aktivitetin e quajtur “My name is Balkan”. Ky aktivitet solli për publikun njëmbëdhjetë shfaqje arti në skenë nga autorë bashkëkohorë dramatikë nga i gjithë Ballkani.
- Mbështeti “Film Music in Pianodrom”.
- Mbështeti komeditë “Plako t’majt e jotja” dhe “Mbroni Shpellarin”.
- Mbështeti dramën “Made in Albania”.
- Mbështeti “ARRËTHYESI”, realizuar nga Qendra Kulturore për Fëmijët.
- Mbështeti Festivalin “Lule Bore” në Shkodër.
- Mbështeti dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit.



Banka Kombëtare Tregtare

- Mbështeti financiarisht Ambasadën Shqiptare në Ankara për organizimin e aktivitetit të Ditës Shqiptare të Pavarësisë, më 28 nëntor.
- Krijoi një ambient të personalizuar në TEG, “BKT

Arena” për të gjithë sportdashësit e futbollit me rastin e kampionatit EURO 2016, në mënyrë që ata të ndiqnin dhe mbështetnin pjesëmarrjen për herë të parë të Shqipërisë me Skuadrën Kombëtare të Futbollit në këtë kampionat të rëndësishëm ndërkombëtar.

Credins Bank

- Mbështeti Qendrën Kombëtare Kulturore të Fëmijëve dhe Tetarin e Kukullave në organizimin e Festës së Fëmijëve, me rastin e 1 qershorit.
- Mbështeti botimin e librit “Udhëkryqje shqiptaro-gjermane”, nga Paskal Milo, një libër që paraqet fakte shkencore të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Gjermanisë.
- Mbuloi shpenzimet e botimit të “Little Wait» libër me poezi, në mbështetje të artit dhe kulturës.
- Mbështeti kompozitorin dhe profesorin shqiptar, Prof. Dr. Shpëtim Kushta, në organizimin e një aktiviteti, duke promovuar kulturën dhe artin.

- Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF) organizoi koncertin me pjesëmarrjen e violinistit Joel Blido. Ky aktivitet u mbështet nga Credins Bank.
- Mbështeti financiarisht Skuadrën e Volejbollit “Studenti” dhe Klubin e Sportit “Studenti” duke mbuluar blerjen e artikujve sportiv, materialeve dhe uniformave për skuadrën e volejbollit për meshkuj.
- Mbështeti shoqatën humanitare jo-qeveritare dhe jofitimprurëse «Under Hope Wings», duke vendosur në skenë komedinë «Hajduti me shumë duar», e shkruar nga artisti, skenaristi dhe regjizori i mirënjohur Haxhi Rama.
- Mbështeti Qendrën Kulturore Kombëtare të Fëmijëve dhe Teatrin e Kukullave, duke mbuluar shpenzimet e shfaqjes “Qeni që nuk dinte të lehte”.
- Mbështeti Bashkinë Pogradec në organizimin e hapjes së sezonit turistik për promovimin e turizmit në qytet.
- Në kontekstin e hapjes së Sezonit Sportiv, Credins Bank mbështeti Federatën Shqiptare të Basketbollit (FSHB). Credins Bank e konsideron mbështetjen e sportit si pjesë të politikave për përgjegjësinë sociale dhe detyrimin ndaj komunitetit.
- Mbështeti Shoqatën «Mega Art» për organizimin e festivalit «Peza n’fest», i cili promovon vlerat e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit.
- Festivali i Pezës shërben si mundësi e mirë për ekspozimin dhe promovimin e burimeve natyrore, agrikulturës, bagëtive dhe produkteve të agro-turizmit.
- Mbështeti shpenzimet e botimit të librit «Prit dhe pak» të Dritëro Agolli, i cili konsiderohet si vlerë e shtuar për letërsinë shqiptare.
- Mbështeti edicionin e 12-të të “Çmimeve Kult” për promovimin e artit dhe kulturës.
- Credins Bank mbështeti shpenzimet e projektit të shfaqjes së teatrit «Arrëthyesi» duke ofruar mbështetje për qendrën kombëtare kulturore të fëmijëve.
- Mbështeti realizimin e publikimit e botimit VIZART. Ky publikim vjen në një formë katalogu, i cili promovon artet pamore përmes pikturave me bojëra uji.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Ofroi mbështetje për Konsullatën e Përgjithshme të Italisë në Vlorë për organizimin e aktiviteteve kulturore, duke përfshirë edicionin e katërt të aktivitetit të tyre vjetor Gala në Marina Orikum, Marina italiane në periferi të qytetit, për promovimin e kulturës italiane të përcjellë përmes modës dhe muzikës.
- Edhe një herë, Banka mbështeti Festën Multikulturore vjetore të Beratit, duke u marrë pjesë në “Panairin e Librit, Agrikulturës dhe Punimeve Artizanale”, i zhvilluar gjatë Festivalit tre-ditor në Bulevardin Republika në Berat.
- Fondacioni Marche, Dhoma e Tregtisë e Ankonës, Universiteti Politeknik i Marche, Qyteti i Ankonës dhe Istao lançuan thirrjen për ide për edicionin e dytë të “ECAPITAL Culture Adriatik Start Up School” për krijimin e një sipërmarrje të re në sektorin e kulturës në rajonin makro të Adriatikut dhe Jonit. Banka promovoi këtë konkurs përmes një larmie kanalesh (media online, postera në internet, postime në Facebook dhe LinkedIn dhe foto profili, e-mail të brendshëm dhe të jashtëm dhe buletine elektronike, të cilat iu dërguan kolegëve dhe listës sonë të OJQ-ve që operojnë në fushën e kulturës).



ARTI, SPORTI & KULTURA

Raiffeisen Bank

- Sponsor i përgjithshëm i aktivitetit social me titull: "Së bashku si një", i organizuar nga Shoqata e Gjymnastikës Artistike, me rastin e 20 majit, Ditës Ndërkombëtare të Jetimëve.
- Partner i Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit dhe sponsor zyrtar i Teatrit Kombëtar, duke ofruar sponsorizime për të gjitha aktivitetet gjatë vitit.
- Për të gjashtin vit radhazi, Banka ishte sponsori i përgjithshëm i emisionit "Tre Tenorët".
- Sponsor i Komitetit Olimpik Shqiptar për Lojërat

Tirana Bank

- Ofroi mbështetje për Federatën "Badminton", të organizuar gjatë 25 dhe 30 qershorit, si dhe për kampin e trajnimit dhe « Memorial Badminton Tournament » në Korçë, ku morën pjesë 27 lojtarë nga mosha 10 deri në 17 vjeç nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia dhe Serbia.
- Këtë vit, Tirana Bank ofroi mbështetjen e saj për «Festivalin e Verës 2016» në Pogradec, me qëllim promovimin e traditës dhe mbështetjen e sipërmarrësve lokalë që promovojnë prodhimin lokal të verës.

ProCredit Bank

- Morri pjesë në Ligën Amatore të Volejbollit, përfaqësuar nga 10 lojtarë, aktualisht punonjës të ProCredit Bank.

Veneto Bank

- Sponsorizoi Federatën Shqiptare të Basketbollit duke kontribuar në ndeshjen Shqipëri - Itali në Pallatin e Sporteve në Tiranë.
- Me rastin e 70 vjetorit të Festës së Republikës së

Union Bank

- Union Bank ka qenë gjithmonë sponsori historik i Ekipit Kombëtar të Futbollit dhe, në vitin 2016, rinovoi marrëveshjen e sponsorizimit me FSHF deri në vitin 2018. Mbështetja ka qenë e vazhdueshme që nga themelimi i Union Bank në 2006 dhe më parë si Union Group që nga viti 1999. Rinovimi i marrëveshjes me Union Bank për Ekipin Kombëtar solli shumë më tepër entuziazëm në sajë të suksesit të madh të Ekipit Kombëtar të Futbollit, falë pjesëmarrjes së tij në Kampionatin Evropian të Futbollit.
- Përveç kësaj, Union Bank dhe FSHF përgatitën një kartë krediti të veçantë për këtë partneritet të quajtur

Olimpik RIO 2016.

- Një projekt shumë i rëndësishëm dhe interesant ishte "QYTETI I LEXUESIT" i zhvilluar në Tiranë dhe Fier, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse. Ky projekt synon të pasurojë bibliotekat e këtyre qyteteve me libra, të cilat do të vendosen në dispozicion të të gjithë përdoruesve të bibliotekave publike.
- Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, Banka mbështeti projektin "REJA", duke e kthyer Tiranën në një qytet atraktiv dhe duke sjellë një strukturë të madhe ndërkombëtare arti nga Sou Fujimoto.

Pas kërkesën e Drejtorisë Arsimore të Pogradecit për pajisjen me kompjuterë të disa shkollave nëntë-vjeçare dhe të mesme në zonat rurale të Pogradecit, Tirana Bank vendosi të mbështesë këtë institucion me blerjen e 10 kompjuterëve.

- Mbështeti Federatën Shqiptare të Pingpongut në ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian.
- Shoqata e Boksit Vllaznia, me mbështetjen e Tirana Bank, organizoi Kupën e Boksit të Republikës së Shqipërisë në qytetin e Shkodrës.

Edhe këtë vit, ProCredit Bank vazhdoi të jetë një nga sponsorët më të rëndësishëm të "German October", të organizuar nga Ambasada Gjermane në Shqipëri.

Italisë, Banka ishte e pranishme në një aktivitet të organizuar nga Ambasada Italiane.

Ofroi mbështetje për koncertin «Boulevard Fest» në «Indrit Çela» në Kavajë, më 20 korrik 2016.

«Unë jam bardh e zi». Në ceremoninë e rinovimit të marrëveshjes, Zëvendës Kryetari i Bordit të Drejtorëve z. Niko Leka shprehu krenarinë për suksesin e ekipit kombëtar dhe entuziazmin që Union Bank do të vazhdojë të jetë partner në sukses dhe do të ofrojë mbështetjen e saj në të ardhmen.

- Stafi i bankës morri pjesë në kampionatin amator të volejbollit dhe futbollit mes institucioneve të ndryshme të organizuara nga FSHF dhe FSHV. Ky aktivitet dhe angazhim, ndër të tjera, promovon veprimtaritë sportive dhe sociale në komunitet, një model i rëndësishëm për edukimin e brezave të ardhshëm.

ÇMIME

American Bank of Investments

- U nderua me çmimin "Bleta e Artë 2016" për Përgjegjësinë Sociale për kontributin e saj në përmirësimin e jetës së komunitetit.
- Banka Amerikane e Investimeve u nderua me çmimin "Banka më pranë komunitetit" nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Banka Kombëtare Tregtare

Banka Kombëtare Tregtare u nderua me çmime të ndryshme prestigjioze në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në Çmimet Vjetore të Ekselencës, Euromoney nominoi Banka Kombëtare Tregtare si "Banka më e mirë në Shqipëri" për të pestin vit radhazi dhe The Banker riafirmoi njohjen e Bankës Kombëtare Tregtare si "Banka më e mirë në Shqipëri" për të shtatin vit. JCR Eurasia Rating riafirmoi vlerësimin AAA (Alb) me një perspektivë të qëndrueshme për Bankën Kombëtare Tregtare për herë të tetin vit radhazi dhe rikonfirmoi vlerësimin AAA (Alb)/E dalluar për Qeverisjen e Korporatave.

- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga EMEA Finance për të gjashtin vit radhazi
- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga EUROMONEY për herë të 5-të
- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga The Banker për të shtatin vit
- Vlerësimi "AAA (Alb) nga JCR - Eurasia Rating që riafirmoi vlerësimin e saj për Bankën Kombëtare

Credins Bank

- Organizata Shqiptare "Shpresa" nderoi Credins Bank me titullin «Banka Humanitare» për mbështetjen dhe kontributin e ofruar si sponsor në edicionin e tretë të koncertit «Shpresës për Shqipërinë», të zhvilluar më 8 maj 2016 në Tiranë.
- Credins Bank mori mirënjohje dhe një falënderim të veçantë nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion

Tregtare për të tetin vit radhazi

- AAA (Alb)/E dalluar për Qeverisjen e Korporatave nga JCR - Eurasia Rating, i cili në bazë të vlerësimit mbi praktikën e qeverisjes së korporatave brenda Bankës Kombëtare Tregtare, e vlerësoi me 87,06 pikë nga 100 pikë (AAA (Alb)/E dalluar) për nivelin e përgjithshëm të përputhshmërisë me Kodin Shqiptar të Qeverisjes së Korporatave dhe me rregulloret përkatëse

Veliaj, për mbështetjen e dhënë në projektin «Adopto një kopsht».

- Credins Bank u nderua me çmimin «Certifikata e Mirënjohjes» nga Bashkia e Tiranës për mbështetjen dhe kontributin e dhënë për përmirësimin e infrastrukturës urbane në qytetin e Tiranës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania fitoi një çmim nga Inspektorati Shqiptar i Punës, Ministra e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për "Krijimi, organizimi dhe funksionimi i duhur i Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë".



